



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.231, datë 24.10.2019

PËR

VERIFIKIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORË PËR REKRUTIMIN SI GJYQTARE TË KANDIDATES, ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 24.10.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit për emërimin si magjistrat, profili gjyqtar, të kandidates znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së mëtejshme për emërimin e saj si gjyqtare,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj {...} është candidate për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtare, në kushtet kur ajo përfshihet në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë në përfundim të vitit akademik 2018-2019, përcjell nga Shkolla e Magjistraturës me Shkresën nr.625 prot., datë 03.07.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3596 prot., datë 03.07.2019.

2. **Me Vendimin nr.103, datë 05.07.2019**, mbështetur në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit për emërimin si magjistrat, profili gjyqtar, për kandidatët e diplomuar në Shkollës së Magjistraturës në përfundim të vitit akademik 2018-2019**, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin

kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit **për kandidaten znj. {...} si relator u caktua z. Alban Toro.**

3. **Më datë 05.07.2019**, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja znj.{...}, në rrugë elektronike, **u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.**

4. Brenda afatit treditör, kandidatja znj.{...}, **depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

5. **Më datë 08.07.2019**, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja znj.{...}, në rrugë elektronike, **iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse** (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidatja znj.{...}, **depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse**, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe **formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave** (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, **më datë 09.07.2019**, kandidatja znj.{...}, në rrugë elektronike, **iu kërkuan të dhëna mbi punësimin/et e saj, të dhëna këto që u dërguan nga kandidatja, në rrugë elektronike, brenda të njëjtës ditë.**

8. **Më datë 10.07.2019**, pas marrjes nga kandidatja të dhënat e punësimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, **u kërkuar informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidates znj. {...} , subjektet të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionin e tyre në periudha të ndryshme kohore.** (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, në datat **10.07.2019, 11.07.2019, 26.07.2019 dhe 29.07.2019**, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, **u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për znj.{...}**.

10. **Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme** (siç do të përshkruhet më poshtë).

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, pas rishqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit të dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, u konstatua se në të mungonin vetëdeklarimet e kandidatës në lidhje me tre prej kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Konkretisht mungonin vetëdeklarimet në lidhje me anëtarësinë në parti politike, me disiplinën në punë (qenien ose jo i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe për pasjen ose jo masë disiplinore në fuqi), si dhe me qenien ose jo bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete. Për këtë, me **datë 07.10.2019**, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatës znj.{...}, në rrugë elektronike, **iu dërguan formularët e vetëdeklarimeve** që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

12. Brenda afatit tregues, **kandidatja znj.{...} depozitoi** në zyrën përkatëse të Këshillit **formularët përkatës të vetëdeklarimeve**.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KUSHTIN DHE KRITERET LIGJORE TË EMËRIMIT SI GJYQTAR

A. Për kushtin e emërimit si gjyqtar

1. Sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës¹ së Shqipërisë dhe nenit 35 të Ligjit të Statusit², për t'u emëruar gjyqtar kërkohet përfundimi i formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe diplomimi.

2. Bazuar në Vendimin nr.3, datë 01.07.2019, të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, përcjell me Shkresën nr.625 prot., datë 03.07.2019, si dhe dokumentacionin e

¹ “1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, **pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.**

2. **Kritere të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj”.**

² “1. **I diplomuari** emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere: ...”.

kandidatja {...}, përcjell me Shkresën nr.635 prot., datë 04.07.2019, të Shkollës së Magjistraturës, konstatohet se kandidatja në fjalë ka përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës Tetor 2016 - Qershor 2019 dhe është diplomuar për magjistrat, profili gjyqtare, në përfundim të vitit akademik 2018 - 2019.

B. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit

1. Kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit, përcaktohen si kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, sikundër po ashtu, sipas neneve 64 dhe 66 të këtij ligji, ato përcaktohen edhe si kriteret zgjedhshmërie, pra si kriteret që magjistrat-ja (gjyqtari) do të duhet t'i plotësojë gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të funksionit.

2. Verifikimi në këtë rast i kriterëve sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit merr shkas nga fakti se kandidatja znj.{...} është pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës përpara hyrjes në fuqi të Ligjit të Statusit, por edhe të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përmes të cilëve kanë pësuar ndryshime kriteret dhe rregullat e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, me tej, edhe ato për emërimin e të diplomuarve në këtë shkollë për magjistratë.

3. Gjithsesi, në respektim të parimit të sigurisë juridike, në lidhje me verifikimin e kriterëve sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, u mbajt në konsideratë ligji i kohës së pranimit të kandidatja znj.{...} në programimin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra Ligji nr.8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullorja e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës dalë në zbatim të këtij ligji. Po ashtu u mbajt në konsideratë edhe ligji aktual në fuqi, pra Ligji i Statusit. Konsiderimi në këtë rast i rregulimeve sipas këtyre dy ligjeve konsiston në atë se vetëm për kriteret që nuk ka ndonjë përcaktim konkret në ligjin e kohës së pranimit në formimin fillestar, kandidatja do të duhet të përmbush këto kriteret sipas ligjit aktual në fuqi.

4. Konkretisht, për kandidaten {...} u verifikuan këto kriteret:

a) *zotësia e plotë për të vepruar*. Për këtë kriter, ndërsa është verifikuar edhe në momentin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) *shtetësia shqiptare*. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar dokumentin “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 16.09.2009, ku pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Ndërkohë, gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidatë. Përkundrazi, nga verifikimi i bërë, më datë 16.10.2019, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga

Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) arsimimi. Për këtë kriter, në rastin e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, kandidatja ka depozituar dokumentet: “Diplomë Bachelor në Juridik i Përgjithshëm”, me nr. {...}, datë 10.09.2012, lëshuar nga Universiteti i Tiranës Fakulteti i Drejtësisë; Certifikatë Notash datë 13.10.2012, lëshuar nga Universiteti i Tiranës Fakulteti i Drejtësisë, Diplomë për përfundimin e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave në Drejtësi”, diplomuar më datë 05.11.2014 dhe Vërtetim Notash datë 25.09.2014, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Vlen të theksohet se për këtë kriter mbahet në konsideratë verifikimi i bërë nga Shkolla e Magjistraturës në momentin e pranimit në provimin e pranimit për në formimin fillestar, sipas përcaktimeve të ligjit të kohës, pra sipas Ligjit nr.8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”;

ç) gjendja gjyqësore. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 22.09.2016. Ndërkohë, gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, u administrua Shkresa nr.V-2531/1 prot., datë 05.08.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidatja nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë;

d) disiplina në punë. Për këtë kriter, gjatë verifikimit, sipas informacionit të marrë nga kandidatja, më datë 09.07.2019, u konstatua se ajo ka qenë e punësuar pranë Studios ligjore “Puto, Topi & Partners” sh.p.k. Nga informacioni i marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me Shkresën nr.5055/1 prot., datë 17.07.2019, rezulton se kandidatja {...} ka qenë e punësuar pranë Studios ligjore “Puto, Topi & Partners” sh.p.k dhe për të janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën Janar 2015 - Nëntor 2016. Sipas Shkresës nr.3729/5 prot., datë 26.07.2019, Studios ligjore “Puto, Topi & Partners” sh.p.k. informon se kandidatja {...} ka qenë në marrëdhënie pune pranë saj për periudhën 22.01.2015-09.11.2016, ndërsa është larguar nga puna me dëshirën e saj dhe se nuk ka pasur masa disiplinore. Prej kandidatës u konstatua se ka qenë në marrëdhënie pune pranë (CIT) Institutit Kanadez të Teknologjisë (Fakulteti Ekonomik). Nga informacioni i marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me Shkresën nr.5055/1 prot., datë 17.07.2019, rezulton se kandidatja {...} ka qenë e punësuar pranë (CIT) dhe për të janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën Maj 2015 - Tetor 2016. Sipas Shkresës nr.418/1 prot., datë 22.07.2019, (CIT) informon se kandidatja {...} ka qenë në marrëdhënie pune pranë saj për periudhën 18.05.2015-31.10.2016 me detyrë pedagoge, ndërsa është larguar nga puna me dëshirën e saj dhe se nuk ka pasur masa disiplinore. Gjithashtu prej kandidatës u konstatua se ka qenë në marrëdhënie pune me kohë të pjesshme pranë Fakultetit të Drejtësisë Universiteti i Tiranës. Sipas Shkresës nr.856/2 prot., datë 24.07.2019, (UT) informon se kandidatja {...}

ka qenë në marrëdhënie pune për periudhën 2015-2016 semestri i dytë i vitit akademik, me detyrë pedagoge joefektive në departamentin e të Drejtës Civile, ndërsa është larguar nga puna me dëshirën e saj dhe se nuk ka pasur masa disiplinore;

dh) anëtarësia në parti politike në kohën e kandidimit. Për këtë kriter, që përcaktohet si kriter zgjedhshmërie, pra edhe emërimi, sipas Ligjit të Statusit, gjatë verifikimit, kandidatja iu kërkua dhe ajo depozitoi një deklaratë me shkrim në të cilën deklaroi se nuk është anëtare e ndonjë partie politike, ndërkohë që nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatës anëtare e ndonjë partie politike;

e) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990. Për këtë kriter u mbajt në konsideratë mosha e kandidatës (e datëlindjes 05.10.1990), çka bën të panevojshëm verifikimin e këtij kriteri pranë autoritetit të ngarkuar nga ligji (Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit), sikurse përcaktohet edhe në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të Vendimit 75/2019:

ë) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete. Për këtë kriter, që përcaktohet si kriter zgjedhshmërie, pra edhe emërimi, sipas Ligjit të Statusit, gjatë verifikimit, kandidatës iu kërkua dhe ajo depozitoi një deklaratë me shkrim në të cilën deklaroi se nuk ka qenë dhe nuk është bashkëpunëtor, informator, ose agjente e shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatës bashkëpunëtor, informator, ose agjente e shërbimeve sekrete.

5. Sa i përket kriterit të *përvojës profesionale aktive me kohë të plotë, të paktën tre vjet*, sipas shkronjës “ç”, të nenit 28, të Ligjit të Statusit, ky kriter është i pa aplikueshëm për këtë kandidatë për shkak se nuk ka qenë kriter ligjor në kohën e kandidimit për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndërkohë që kandidatja ka përfunduar programin e formimit fillestar dhe është diplomuar tashmë.

B. Për kriterin e pasurisë

1. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 49/27 prot., datë 11.09.2019.

2.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidaten {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

2.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrollin e plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja {...}, duke konkluduar se për kandidaten:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 13610/1 prot., datë 19.07.2019, ku për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë për aktivitet tregtar të regjistruar.

3.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 18232/1 prot., datë 23.07.2019, ku për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

4. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

5. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të formularit të deklaratës së pasurisë;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të nënshkruara, të autorizimeve të kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) burimet financiare të kandidates dhe justifikimin ose jo të pasurisë së saj;
- ç) plotësinë, vërtetësinë dhe saktësinë ose jo, të deklaramit të pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar.

C. Për kriterin e figurës

1. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

3. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

4. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, asaj iu kërkua dhe ajo plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 10.07.2019, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

4.1 Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 2057/103 prot., datë 14.10.2019, Vendimin “Për rezultatet e verifikimit për subjektin {...}”, sipas të cilit është vlerësuar se *“Subjekti deklarues {...}, kandidate për gjyqtare, e diplomuar në shkollës e Magjistraturës në vitin 2018-2019, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

4.2. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 6418/1 prot., datë 04.09.2019, ka dërguar në Këshill të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidaten {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

4.2.1 Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidatja {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të

personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

5. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të tij. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të nënshkruara, të autorizimit për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) ekzistencën ose jo të lidhjeve ose kontakte të papërshtatshme të kandidates me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) qenien ose jo të kandidates, anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- d) qenien ose jo të kandidates, bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës.

III. KONKLUZIONE

Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

2. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush këto kritere, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates për emërim magjistrat, profili gjyqtare.

PËR KETO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 35 në lidhje me nenin 32 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimet e Këshillit nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” dhe Vendimin nr.103, datë 05.07.2019 “Për caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kritereve për secilin kandidat për gjyqtar të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019”, në propozimin e relatorit pranë Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Të kualifikojë për emërim, kandidaten {...} e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018 – 2019 dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidatës.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR